



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 44 Datë 10.03.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” **kreu III, pika 1, gërma ë**, dhe Vendimit nr. 76 prot datë 02. 08. 2017, **pika I**, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e datës 10.03.2020 miratoi me 19 vota pro

VENDOSI :

- I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
- II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 1 kat** në pronësi të **z. Bashkim Makishti** njësia administrative Kastriot (lagjia Makishte, fshati Sohodoll) në shumën totale **146750** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **146750** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **ska**.
- III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **73375** lekë (50 % të vlerës totale të dëmit).
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Sekretare Këshilli

Inva Trupja

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

